



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.487/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Smartivo LLC me numër identifikues 810842957, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi, që të dytë avokat në Prishtinë, kundër debitorit M.M. B.I. (Dromodoli Commerc) me numër identifikues 810403337 me seli në Pejë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP nr.937/23 datës 20.12.2023, me datën 08.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Smartivo LLC me numër identifikues 810842957, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP nr.937/23 i datës 20.12.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP nr.937/23 dt.20.12.2023, ka Pranuar si të bazuar propësimin e debitorit M.M. B.I. (Dromodoli Commerc) me numër identifikues 810403337 me seli në Pejë, dhe ka Anuluar Urdhrin përmbartimor P.nr.189/23 datës 31.05.2023, i Përmbartuesit Privat Fazli Gjonbalaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, përmes përfaqësuesve të autorizuar, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore/kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, të Ndryshohet aktvendimi KPPP nr.937/23 dt.20.12.2023 ashtu që të refuzohet propësimi i debitorit dhe te pranohet urdhri përmbartimor P.nr.189/23.

Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Smartivo LLC me numër identifikues 810842957, me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi, që të dytë avokat në Prishtinë, me datën 31.05.2023 ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit M.M. B.I. (Dromodoli Commerc) me numër identifikues 810403337 me seli në Pejë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.22-SHV01-001-63 dt.24.02.2022, 22-SHV01-001-26 dt.25.05.2022, 22-SHV01-001-563 dt.22.06.2022, 22-SHV0-001-709 dt.02.0-7.2022, 22-SHV01-001-855 dt.25.08.2022, 22-SHV-1-001-1004 dt.27.09.2022, 22-SHV01-001-1151 dt.29.10.2022, 22SHV01-001-1305 dt.30.011.2022, 22-SHC01-001-1448 dt,31.12.2022, 23-SHV01-001-60 dt,26.01.2023, 23-SHV01-001-211 dt.22.03.2023.

Përmbarruesi Privat Fazli Gjonbalaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.189/23 dt.31.05.2023, ka lejuar përmbarrimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga faturat, t,ia paguaj shumën në vlerë prej 778,80€, me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbarrimit, debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se faturat mbi bazën e të cilave është lëshuar urdhri nuk janë pranuar asnjëherë nga ana e debitorit për faktin se të njëjtat nuk janë të nënshkuara dhe të vulosura nga debitori. Propozimi për përmbarrim është në kundërshtim me nenin 38 të LPP-së, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit.

Përgjigje ndaj prapësimit të debitorit ka ushtruar kreditori duke kundërshtuar në tërsi pretendimet e debitorit. Nuk qëndron pretendimi i debitorit se nuk ka pranuar faturat objekt i këtij përmbarrimi, pasi që secila faturë i është dorëzuar debitorit përmes adresës elektronike, ndërsa vet debitori, në prapësim ka theksuar se debitori ka bërë pagesa të kohë pas kohshme, deklarim ky që paraqet pohim të borxhit nga debitori, i propozon gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta aprovoj urdhrin përmbarrimor.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.937/23 dt.20.12.2023, me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përmbarrimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit dhoma e shkallës së parë vlerëson se faturat në bazë të cilës është lejuar urdhri përmbarrimor nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 të LPP-së. Gjykata vlerëson se faturat nuk janë dokument i besueshëm për faktin në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që të njëjtat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qene se faturat nuk përmban nënshkrimin apo vulën e biznesit të debitorit, dhe në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se faturat janë pranuar nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të Faturave nr.22-SHV01-001-63 dt.24.02.2022, 22-SHV01-001-26 dt.25.05.2022, 22-SHV01-001-563 dt.22.06.2022, 22-SHV0-001-709 dt.02.0-7.2022, 22-SHV01-001-855 dt.25.08.2022, 22-SHV-1-001-1004 dt.27.09.2022, 22-SHV01-001-1151 dt.29.10.2022, 22SHV01-001-1305 dt.30.011.2022, 22-SHC01-001-1448 dt,31.12.2022, 23-SHV01-001-60 dt,26.01.2023, 23-SHV01-001-211 dt.22.03.2023, të lëshuara nga kreditori, në mënyrë të njëanshme, e të cilat fatura nuk përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP-së.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga dhoma e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Edhe kjo gjykatë vlerëson se faturat e lartcekura, nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore dhe atë nenin 29 te LPP i cili parasheh që *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*, e që në rastin konkret faturat, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, sepse të njëjtat nuk janë të vulosura nga debitori si dhe as e nënshkruar nga i njëjti, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e pranimin të një dokumenti, dhe se të njëjtat nuk janë pranuar në mënyrë të rregullt ashtu që del të jetë e lëshuar njëanshëm. Po ashtu kjo gjykatë vlerëson se me Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, andaj marrë parasysh faktin se faturat nuk janë nënshkruar nga debitori dhe se në shkresat e lëndës nuk ka prova se të njëjtat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori rezulton se këto fatura nuk mund të jenë e përshtatshme për përmbarim.

Dhomat e shkallës së dytë, nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet ankimore të kreditorit, dhe jo relevante për një vendosje ndryshe ashtu që i refuzoi si të tilla ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoi. Pretendimet se debitori ka pranuar borxhin përmes komunikimit elektronik, kjo gjykatë nga shkresat e lëndës, vërteton se nuk kemi pranim të rregullt të borxhit nga ana e debitorit, por gjenden vetëm kërkesat e kreditorit drejtuar debitorit për pagimin e borxhit

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.487/24 me datë 08.07.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha